



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E  
PROJEKTEVE STRATEGJIKE,  
EVROPËS, MIGRACIONIT, DIASPORËS,  
KOMUNIKIMIT DHE TRANSPARENCËS

Nr. 306/Prot.

Lezhë, më 12/01/2026

RELACION  
“PËR  
MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE  
DIASPORËN 2026-2030”

Në mbështetje të ligjit Nr. 8417., datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, ligji Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligji Nr. 119/2015 “Për të drejtën e informimit”, ligji Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, VKM Nr. 88., datë 22.02.2023 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim europian 2022-2030”, VKM Nr. 271., datë 02.05.2024 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për migracionin 2024-2030 dhe të planit të saj të veprimit 2024-2026”, VKM Nr. 173., datë 24.03.2023 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të punësimit dhe aftësive 2023-2030”, VKM Nr. 621., datë 22.10.2021 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”, si dhe Strategjia Ndërsëktoriale për Decentralizim dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030”;

Bashkia Lezhë ka përgatitur Planin Vendor të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën 2026-2030, një dokument strategjik i rëndësishëm, qëllimi i të cilit është të ndërtojë një infrastrukturë të përshtatshme për të menaxhuar me efikasitet dhe koordinimin e çështjeve të migracionit dhe diasporës duke i bërë ata faktorë të rëndësishëm në zhvillimin social-ekonomik lokal.

Nëpërmjet këtij plani Bashkia Lezhë synon të sigurojë mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga vendndodhja e tyre, dhe punon për të nxitur përfshirjen dhe integrimin e tyre me të drejta të plota dhe të barabarta. Misioni i Bashkisë është të përqendrohet në ofrimin e shërbimeve dhe lehtësirave në realitetin ekonomik-social për qytetarët. Për të arritur këtë, është e nevojshme një menaxhim i përmirësuar i burimeve vendore, një planifikim strategjik më efikas, forcimi i kapaciteteve administrative dhe profesionale të administratës vendore, si dhe rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendim-marrëse. Në thelb, qeverisja e mirë dhe zhvillimi i qëndrueshëm janë objektivat kryesore që pushteti vendor duhet të sigurojë për mirëqenien dhe përparimin e komunitetit lokal.

Hartimi i Planit Vendor të Veprimit për migracionin dhe diasporën në bashkinë Lezhë u realizua në kuadër të Programit të GIZ “Formimi i Migrimit të Orientuar të Zhvillimit”, i mbështetur financiarisht nga Qeveria Gjermane. Ky plan është bazuar në Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe në udhëzimet për planifikimin e territorit të miratuara nga Këshilli i Ministrave , VKM. Nr.671 , datë 29.07.2015 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”. Ligji Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe ndryshimet dhe shtesat e bëra me ligjin Nr. 38/2019 , datë 20.06.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.139/2015”, adresojnë nevojën për hartimin e këtij plani, duke e bërë atë një element shtesë për qeverisjen e Bashkisë Lezhë, duke përfshirë migracionin dhe diasporën në procesin e planifikimit, veprimit dhe monitorimit të projekteve dhe planeve që lidhen me ta. Ndër të tjera, ndryshimet në ligjin për vetëqeverisjen vendore , bazuar në nenin 54 të ligjit nr.39/2015 ”Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar me ligjin nr.38/2019, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.139/2015” i cili përcakton funksionet e bashkisë në zhvillimin ekonomik lokal, shërbimet dhe përfshirjes sociale, Plani Vendor për Migracionin dhe Diasporën hartohet si instrument sektorial që adreson ndikimet sociale dhe ekonomike të migracionit dhe diasporës në nivel vendor duke thelluar përgjegjësitë e tyre për këto çështje të nivelit lokal.

Ky plan adreson:

1. Krijimi i një strukture të specializuar për menaxhimin e shërbimeve të diasporës dhe migracionit në nivel lokal, si pjesë e administratës së njësisë së vetëqeverisjes vendore;
2. Inkurajimi i organizatave brenda dhe jashtë vendit për të ruajtur komunikimin dhe forcimin e lidhjeve me diasporën dhe emigrantët shqiptarë;
3. Ofrimi i ndihmës dhe informacionit për procesin e fitimit të shtetësisë shqiptare;
4. Furnizimi me ndihmë dhe informacion për të interesuarit nga diaspora dhe migracioni rreth legjislacionit shqiptar për investimet, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për investimet;
5. Koordinimi me ministrinë përgjegjëse për punët e brendshme, të jashtme dhe për diasporën për sigurimin e ndihmës dhe informacionit për çështjet lidhur me diasporën dhe migracionin.

Objektivat kryesorë të planit janë:

1. Organizimi dhe koordinimi institucional i diasporës dhe migracionit në nivel vendor.
  - Organizim funksional dhe operativ i strukturës vendore për migracionin dhe diasporën.
  - Rritja e aftësive profesionale të specialistëve në njësitë vendore që trajtojnë çështjet e migracionit.
  - Ndërtimi i marrëdhënieve të qëndrueshme dhe afatgjata me komunitetet e diasporës dhe emigrantët e rikthyer.
2. Shërbimet sociale publike me bazë komunitare.
  - Informim i vazhdueshëm në lidhje me të drejtat dhe përgjegjësitë.
  - Përfshirje dhe riintegrim i migrantëve të kthyer dhe komuniteteve të diasporës nëpërmjet garantimit dhe aksesit në shërbime sociale.
3. Zhvillimi dhe rritja e potencialit ekonomik të komunitetit lokal.
  - Përcaktimi dhe shpërndarja e nevojave vendore të komunitetit me diasporën dhe migrantët.
  - Garantim i ndihmës për të përmirësuar investimet publike dhe private nga komuniteti i diasporës dhe migrantët e kthyer.

Nëpërmjet këtyre masave dhe politikave, synohet të krijohen struktura funksionale dhe politika të përshtatshme për menaxhimin e migracionit dhe statusit të diasporës shqiptare në botë, duke thelluar ndërveprimin e tyre në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit. Kjo përfshin përfshirjen e diasporës në procesin e planifikimit të nivelit lokal dhe hartimin e një manuali me objektiva dhe masa strategjike për këtë qëllim, duke përcaktuar rolin e aktorëve të interesuar në fushën e migracionit dhe diasporës.

Mbi sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Migracionin & Diasporën 2026-2030.

Bashkëngjitur, gjeni Planin Vendor të Veprimit për Migracionin & Diasporën 2026-2030.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**KRYETARI**  
**Pjerin NDREU**

